



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/323
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202201273/2

Tiranë ___/___/2022

Lënda: *Rekomandohet përmirësimi i menjëhershëm i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Kosovë, Lushnjë.*

Drejtuar: **Z. Admir ABRIJA**
Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve

TIRANË

Z. Apostol LUCA
Drejtor i Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale

KOSOVË -LUSHNJË

Të nderuar,

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim "Mekanizmi Kombëtar", ose (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe nenin 81 të ligjit nr.81/2020, datë 25.06.2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim periodik në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në Kosovë-Lushnjë më datë 03.11.2022, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita, z. Besnik Deda, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Objektivi kryesor i inspektimit ishte vlerësimi i kushteve në IEVP Kosovë-Lushnjë, për garantimin e sigurisë, jetës, shëndetit dhe krijimin e ambienteve të përshtatshme për të burgosurit që vuajnë dënimin në këtë institucion, me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e tyre; trajtimi dhe respektimi i të drejtave të të burgosurve në përputhje me dispozitat ligjore dhe nënligjore, si dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim; kontrolli dhe administrimi i dokumentacionit që evidenton punën e kryer sipas sektorëve; si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra në inspektimin e mëparshëm.

Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka të drejtën e detyrimit kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

Shënime të përgjithshme

Grupi i inspektimit bazuar në metodologjinë e inspektimit në burgje, zhvilloi paraprakisht një takim me drejtorin e institucionit z. Apostol Luca, i cili u njoh me qëllimin e inspektimit.

Në takim, drejtuesi i institucionit informoi grupin e inspektimit për situatën e popullimit të të paraburgosurve në institucion, gjendjen dhe kushtet në të cilat ndodhen ambientet e dhomave dhe atyre të përbashkëta në regjimin e brendshëm, ku mbahen dhe trajtohen të dënuarit, masat e marra nga secili nga sektorët dhe shërbimi i sigurisë së institucionit për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të të dënuarve në këto ambiente, mënyrën e funksionimit të sistemit të trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesë/ankesave, gjendjen shëndetësore dhe psiko-sociale të të dënuarve, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Nisur nga infrastruktura e godinave në regjimin e brendshëm, elementët e sigurisë, cilësia e shërbimeve që ofrohen, si dhe ambientet e jashtme që shërbejnë për ajrim dhe aktivitete të përbashkëta, theksojmë se I EVP në Kosovë-Lushnjë **nuk garanton** standarde të kënaqshme për sa i përket kushteve për të dënuarit.

Sipas informacionit, I EVP Kosovë-Lushnjë, bazuar në Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.381, datë 19.07.2019 "Për disa ndryshime në Urdhrin nr.8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë "*Për kategorizimin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale*", kategorizohet "*Burg i sigurisë së zakonshme*", me një seksion të dënuar në siguri të zakonshme.

Kapaciteti fizik i institucionit ishte për mbajtjen, akomodimin dhe garantimin e kushteve për trajtimin dinjitoz të **185** personave. Në ditën e inspektimit në ambientet e regjimit të brendshëm ndodheshin 155 të dënuar, të cilët ishin akomoduar sipas sipërfaqeve të dhomave të banimit, pasi mungonte një urdhër zyrtar për kapacitetin e I EVP-ve për të akomoduar të burgosur sipas standardeve dhe akteve ligjore në fuqi.

Gjithashtu, grupi i inspektimit kërkoi informacion për situatën e popullimit edhe për periudhën vjetore të inspektimit, e cila rezultoi si më poshtë vijon:

- Muaj Maj 176 persona
- Muaj Qershor 171 persona
- Muaj Korrik 171 persona
- Muaj Gusht 161 persona
- Muaj Shtator 157 persona
- Muaj Tetor 154 persona

Sikurse paraqitet nga statistikat e raportuara, në I EVP Kosovë-Lushnje ka patur situata mbipopullimi për periudhën e inspektimit për sa kohë që nuk ka një urdhër zyrtar nga Drejtoria e Përgjithme e Burgjeve, për përcaktimin e standardeve të dhomave të banimit nëpër I EVP -të, fakti se shtimi me shtretër në dhomat e banimit duke i kufizuar të burgosurve parametrat e nevojshëm të hapësirës dhe sipërfaqes jetike për një person në dhomat e banimit nuk do të se thotë është brenda kapaciteteve zyrtar të institucionit.

Shkelja e këtyre standardeve bazike për jetesë, përbën trajtim jo dinjitoz të personave që vuajnë dënimin në këtë institucion.

Sipas nenit 33 pika 4, të ligjit nr.81/2020, datë 25.06.2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, thuhet se në vendosjen e të burgosurve mbahen parasysh kushtet dhe mundësitë konkrete të çdo institucioni të ekzekutimit të vendimeve penale, si dhe kushtet e mundësitë e të burgosurve, por në çdo rast duke iu siguruar kubatura jo më pak se 9 m³ dhe sipërfaqja e banimit jo më pakse 4 m² për çdo të burgosur, dritare që mundësojnë ajrim të mjaftueshëm dhe ndriçim natyral normal për të lexuar e punuar.

Godinat në regjimin e brendshëm dhe infrastruktura e institucionit, garantonin sigurinë dhe kushtet e qëndrimit të të dënuarve, për kryerjen e veprimeve sipas orarit ditor, por dhe për të përballuar dinamikën e hyrjeve të reja dhe transferimit të të dënuarve nëpër I EVP të tjera, sipas kërkesave të tyre.

Organika e miratuar për I EVP Kosovë-Lushnjë përbëhej nga 126 punonjës, nga të cilët 24 ishin punonjës civil dhe 102 punonjës me uniformë të sektorit të shërbimit të sigurisë së institucionit. Organika ishte plotësuar në sektorin ligjor, sektorin e financave dhe buxhetit, por kishte mungesa në sektorin shëndetësor me një mjek me kohë të reduktuar, dhe sektorin e policisë me 2 punonjës të rolit bazë. Ndërsa në sektorin e burimeve njerëzore dhe sektorin e kujdesit social ishin të pezulluar nga puna, 4 punonjës, konkretisht përgjegjësi i burimeve njerëzore, një kuzhiner dhe 2 punonjës specialistë të edukimit, me urdhër të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për shkak të fillimit të një hetimi penal të ngritur nga organi i akuzës ndaj tyre për veprën penale “shpërdorim detyrë”.

Mungesat e konstatuara në organikë, kryesisht të stafit psiko-social, të përgjegjësit të burimeve njerëzore, të kuzhinierit, të mjekut me kohë të pjesshme dhe të stafit policor, në vlerësimin e MKPT-së përbëjnë problem shqetësues për garantimin e sigurisë dhe shëndetin e të burgosurve. Ndaj është urgjente që nga DPB-ja të përshpejtohen procedurat e rekrutimit të punonjësve civil dhe atyre policor, sipas detyrave funksionale, me qëllim garantimin e kushteve për trajtimin me dinjitet të të dënuarve me burgim, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të tyre që synojnë rehabilitimin për riintegrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike.

Sa i takon plotësimin të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i datës 26.11.2021¹, nga informacioni dhe evidentimi në vend i kushteve ku mbahen dhe trajtohen të dënuarit, si dhe nga intervistat konfidenciale të zhvilluara me grupe e individë në këtë institucion, rezultoi se:

1. Ishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e një fushe futbollit në ambientet e I EVP Kosovë-Lushnjë për vendosjen e një standardi argëtues dhe çlodhës për të paraburgosurit në këtë institucion.
2. Ishte zbatuar rekomandimi, për sigurimin e ilaçeve të të paraburgosurve nga skema e rimbursimit, duke bërë efektive marrëveshjen tre palëshe midis institucioneve të

¹ Dërguar rekomandimi nr. K4/I77-2 prot, datë 16.02.2022, për përmirësimin e kushteve dhe të trajtimit të të dënuarve në I EVP Kosovë-Lushnjë.

Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Depos Farmaceutike.

3. Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi, për vënien në punë të aparateve të telefonave që ndodhen në regjimin e brendshëm, për plotësimin e nevojave të të burgosurve për kryerjen e bisedave telefonike me familjarët e tyre, si dhe hapjen e linjës pa shpërblim për numrat e kontaktit me Avokatin e Popullit dhe komunikimin e të burgosurve me institucionin në lidhje me adresimin e ankesave, por jo për shtimin e operatorëve telefonik.
4. Ishte zbatuar rekomandimi, për shtimin e një post kompjuteri për takime online me familjarët e tyre. Të burgosurit të kenë më shumë akses për planifikimin dhe kohëzgjatjen e orarit të takimeve online.
5. Ishte zbatuar rekomandimi, për të sjellë në përputhje me standardet, dhomat e prindërimit në distancë dhe pajisjen e tyre me bazë materiale, për të mundësuar realizimin e takimeve mes të dënuarve dhe fëmijëve të mitur të tyre, në kuadrin e garantimit të prindërimit në distancë.
6. Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi, për marrjen e masave për rikonstruksionin dhe pajisjen me bazë materiale sipas standardeve të dhomave të takimeve të veçanta në IEVP Kosovë-Lushnjë, por kishte nevojë për pajisjen e tualetit me mjete hidrosanitare dhe vënien në funksion të dushit për larjen e tyre.

Ndërkohë, disa nga rekomandimet ende nuk kishin gjetur zbatim dhe konkretisht:

7. Nuk është zbatuar rekomandimi, për gjetjen e fondeve përkatëse për ndërtimin/rikonstruksionin e godinave të banimit të të dënuarve në IEVP Kosovë-Lushnjë, për të siguruar ambiente të përshtatshme dhe dinjitoze².
8. Nuk është zbatuar rekomandimi, për hidroizolimimin e tarracës të godinës së banimit, për eliminimin e lagështirës në dhomat e të dënuarve dhe në ambientet e përbashkëta të dusheve dhe tualeteve.
9. Nuk është zbatuar rekomandimi, për të krijuar ambientet e përshtatshme për të ofruar shërbimet shëndetësore.
10. Nuk është zbatuar rekomandimi, për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë, si dhe të stafit civil, sipas parashikimeve në organikën e IEVP Kosovë-Lushnjë.
11. Nuk është plotësuar rekomandimi, për akomodimin e personave të moshës 18-21 vjeç në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë për këtë kategori.
12. Nuk është plotësuar rekomandimi, për furnizimin me ujë të pijshëm 24 orë në ditë në ambientet e IEVP Kosovë-Lushnjë dhe deri në realizimin e plotë të investimit të

² Institucioni i Ekzekutimeve të Vendime Penale Kosovë-Lushnjë me shkresën nr. 400/1 prot, datë 15.03.2022, ka kthyer përgjigje rekomandimeve tona.

rritet numri i orareve të furnizimit me ujë në 10 orë në ditë, nga 6 orë që është aktualisht.

- 13.** Nuk është plotësuar rekomandimi, për të realizuar mbulimin me kamera në të gjithë ambientet e I EVP Kosovë-Lushnjë, pasi masa 45% që mbulohet aktualisht është e papërshtatshme.
- 14.** Nuk është zbatuar rekomandimi, për eliminimin e plotë të lagështirës në ambientet e kuzhinës, blerjen e pajisjes për aspirimin dhe ventilimin e ajrit, si dhe lyrjen dhe mbajtjen pastër të këtyre ambienteve në I EVP Kosovë-Lushnjë.
- 15.** Nuk është zbatuar rekomandimi, për zëvendësimin e enëve të vjetëruara të kuzhinës, që shpërbejnë për shpërndarjen e ushqimit të të dënuarve, me enë të reja, si dhe pajisjen e kuzhinës me frigorifer për të mbajtur produktet sipas stinëve.
- 16.** Nuk është zbatuar rekomandimi, për përmirësimin e ushqimit sipas produkteve të stinës, si dhe ushtrimin e kontrolleve të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit për këtë problematikë.
- 17.** Nuk është zbatuar rekomandimi, për përmirësimin e higjienës në dhomat e banimit të të dënuarve dhe në ambientet e përbashkëta në institucion.
- 18.** Nuk është zbatuar rekomandimi, për marrjen e masave për parandalimin e virusit COVID-19, si dhe për furnizimin me detergjentë dhe pajisje higjieno-sanitare shtesë, sipas normativave mujore për dënuarit, për mbajtjen e higjienës personale dhe të pastërtisë së dhomave të banimit dhe ambienteve të përbashkëta. Ushtrimin e kontrolleve të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit, për verifikimin e furnizimit me detergjentë sipas normativave mujore për të burgosurit, si dhe të marrjes së firmave të cilat vërtetojnë marrjen në dorëzim të këtyre materialeve prej tyre.
- 19.** Nuk është zbatuar rekomandimi, për krijimin e Sektorit të Kujdesit të Veçantë (SKV) në I EVP Kosovë-Lushnjë.
- 20.** Nuk është zbatuar rekomandimi, për instalimin në godinën e të dënuarve të sistemit qendror për ngrohje/ftohje, si dhe ndërprerjen e lidhjeve të kabllave të rezistencave elektrike që përdoren për ngrohje, pasi përbëjnë rrezik për jetën e të paraburgosurve.
- 21.** Nuk është zbatuar rekomandimi, për pajisjen e institucionit me autoambulancë, për transportin e të sëmurëve në rastet e emergjencave shëndetësore.

Është rasti të theksojmë se garantimi i kushteve për trajtimin me dinjitet të të dënuarve me burgim, respektimi të drejtave dhe lirive themelore të tyre dhe parandalimi i sjelljeve ose trajtimit mizor, çnjerëzor, poshtërues apo degradues, si dhe rekomandimet e CPT-së dhe të Avokatit të Popullit duhen vlerësuar maksimalisht nga institucionet që ato ju drejtohen. Këto rekomandime nuk ju drejtohen personave të caktuar personalisht, por institucioneve të administratës publike dhe drejtuesve të tyre me cilësinë e titullarit. Ne vlerësojmë se nuk është qëndrim aspak serioz, moszbatimi i rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit, pasi pavarësisht ndryshimit të vazhdueshëm të titullarëve të institucioneve, ata

kanë detyrimin ligjor në zbatim neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, të zbatojnë për të përmirësuar gjendjen në të cilën vuajnë denimet të të dënuarit. Nga ana tjetër vlerësojmë përmirësimet e bëra në disa aspekte, sipas rekomandimeve të lëna për vitin 2021.

Inspektimi i MKPT-së në IEVP Kosovë-Lushnjë u krye pa paralajmërim dhe pa mbikëqyrjen e stafit të institucionit gjatë zhvillimit të intervistave konfidenciale me të burgosurit, si dhe u zhvillua në përputhje me procedurat e parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Në përfundim, grupi i inspektimit administroi gjithashtu kopje të dokumentacionit të disa praktikave sipas sektorëve, konkretisht:

- Organikën e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kosovë-Lushnjë.
- Listën e vendosjes së të dënuarve sipas dhomave.
- Listën e të dënuarve të shëndetit mendor.
- Listën e medikamenteve.
- Organikën e punës për të burgosurit.
- Plan aktiviteti.
- Raport incidenti.
- Dosje Psiko-Sociale.
- Program i individualizuar trajtimi për të rinjtë.
- Kontratë individuale e punës.

Trajtimi i të dënuarve

Grupi i inspektimit të MKPT-së u informua nga drejtuesit e institucionit, por zhvilloi edhe intervista konfidenciale me të burgosurit, në lidhje me trajtimin e tyre nga stafi i institucionit, me qëllim identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike tej kufijve të parashikuar me akte normative apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie.

Nga intervistat e zhvilluara me të dënuarit, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime për keqtrajtme dhe tejkalim të forcës fizike nga punonjësit e sigurisë të këtij institucioni. Sikurse ata pohuan në këto intervista, marrëdhëniet e stafit me të burgosurit, janë të mira dhe korrekte.

Grupi i inspektimit, verifikoi edhe plotësimin e kushteve materiale të jetesës për të dënuarit në këtë institucion. Inspektimi u përqëndrua kryesisht tek kushtet e banimit, higjiena personale, kushtet sanitare, veshjet, cilësia e përgatitjes dhe shpërndarjes në kohë e ushqimit, ndriçimi, ventilimi, ngrohja, ambientet e takimit me familjarët, komunikimi telefonik dhe monitorimi me kamera i ambienteve të përcaktuara sipas skemës së sigurisë.

Personat e moshës 18-21 vjeç **nuk** ishin të akomoduar në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualin e sigurisë për këta persona, por ata ishin të shpërndarë në dhoma me të dënuar të rritur.

Nga intervistat konfidenciale të zhvilluara me të dënuarit, rezultoi se kishte disa ankesa që ishin të lidhura kryesisht me kushtet e përgjithshme të jetesës në institucion. Ato

konsistonin në prezencën e lagështirës në disa dhoma banimi dhe kryesisht në ambientet e përbashkëta, si në tualete dhe dushe; problemet me sistemin elektrik dhe mungesën e sistemit qendror për ngrohje/ftohje, për t'iu përshtatur kushteve klimaterike; mungesën e ujit të ngrohtë për larjen e trupit; etj.

Gjatë inspektimit, evidente në këtë institucion ishte mosfunksionimi i sistemit qendror për ngrohje/ftohje në regjimin e brendshëm. Në mungesë të këtij sistemi, të dënuarve u ishte mundësuar futja e ventilatorëve freskues në periudhën e verës dhe kaloriferëve ose rezistencave ngrohëse në periudhën e dimrit.

Gjithashtu, një problematikë tjetër që u evidentua nga intervistat me të burgosurit, kishte të bënte me pamjaftueshmërinë sipas normativave mujore të detergjenteve dhe pajisjen e tyre me mjetet e higjenës, të cilat shërbejnë për mbajtjen pastër të higjenës personale dhe të ambienteve në regjimin e brendshëm. Sektori i logjistikës kishte një regjistër të veçantë ku evidentohet marrja e normativave mujore, por nisur nga ankesat e ngritura në intervistat me të burgosurit, ata pretendonin se shpërndarë nga personeli i institucionit dhe përpos kësaj normativat mujore të pajisjes me detergjente ishin shumë të vogla.

Në intervistat me të dënuarit, u ngrit si shqetësim mungesa në organikë e një mjeku me kohë të plotë, për shkak të nevojës që ata kishin për kryerjen në kohë të vizitave mjekësore apo lëshimit të rekomandimeve për vizita mjekësore, pranë mjekëve specialist në Spitalin Rajonal Lushnjë. Mjeku që kryente detyrën në këtë institucion, nuk ishte me kohë të plotë, por ishte i punësuar me kontratë me kohë të reduktuar, në 4 orë të çdo dite të javës dhe koha për të kryer vizita mjekësore nuk ishte e mjaftueshme, pasi numri i kërkesave të të burgosurve për vizita mjekësore, ishte i lartë. Kjo situatë, kishte kufizuar të drejtën e të dënuarve për të marrë shërbim shëndetësor më të specializuar pranë spitaleve apo klinikave mjekësore, që ndodhen në qytetin e Lushnjës. Gjithashtu, sipas të dënuarve shërbimi mjekësor në këtë institucion nuk ishte në nivelin e kërkuar dhe nuk ofrohej brenda standardve të parashikuara në ligj dhe në akte nënligjore.

Koha në dispozicion për vizitat mjekësore nga mjeku, ishte në varësi të numrit të kërkesave dhe diagnozës që paraqisnin të dënuarit dhe kryhej brenda ditës ose maksimumi brenda 2 ditëve. Ndërsa, vizita mjekësore pranë mjekëve specialist në Spitalin Rajonal të Lushnjës, në bazë të rekomandimit të mjekut të institucionit, kryhej në varësi të garantimit të masave të sigurisë për lëvizjen e të sëmurëve nga IEVP për në spital, menjëherë për rastet urgjente ose brenda një jave.

Një problematikë tjetër që u evidentua nga intervistat me të burgosurit, kishte të bënte me mungesën e furnizimit me ujë të rrjedhshëm dhe mungesën e ngrohjes së ujit sanitar që shërbente për larjen e të burgosurve. Sipas tyre, furnizimi me ujë i ambienteve të brendshme kryhej 3 herë në ditë, me orare të reduktuara 2-4 orë, i cili ishte i pamjaftueshëm për të përballuar nevojat e të burgosurve.

Të burgosurit ngritën si shqetësim mungesën e prezencës në sektorë të punonjësve të sektorit të çështjeve shoqërore dhe të juristit. Ankesat konsistonin në nevojën që kishin të burgosurit për trajtime psiko-sociale, me qëllim uljen e stresit dhe të ankthit, mungesën e asistencës së stafit në marrjen e kërkesë/ankesave të të burgosurve, dhënien e ndihmës juridike për çështje që lidhen me veprën penale të kryer nga ana e tyre, si dhe për llogaritjen e kohës së dënimit.

Drejtuesit e institucionit e justifikonin këtë situatë, me mungesat në organikë të punonjësve në sektorin e çështjeve shoqërore, të cilat vijonin të ishin pezulluar për shkak të një hetimi penal të zhvilluar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, por sipas drejtuesit të institucionit kjo situatë do të marrë zgjidhje menjëherë për plotësimin e organikës sipas strukturës së miratuar.

Në IEVP Kosovë-Lushnjë ishin të punësuar 19 të dënuar, nga 17 që ishin të miratuar sipas strukturës organike, në pozicione pune si sanitarë, ndihmës kuzhiner, shpërndarës ushqimi, bojaxhi, lavanteri, lulishtar, berber etj. Sipas intervistave me të paraburgosurit, punësimi nuk paraqet interesim për sa kohë që kushtet e punësimit dhe shpërblimi nuk janë të rregulluar me aktet nënligjore, sikurse parashikohet në nenet 43 dhe 44 të ligjit nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM nr. 209 datë 06.04.2022, si dhe VKM nr.602 datë 13.10.2021 *“Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”*; të urdhrimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr. 169, datë 16.05.2022 *“Për lidhjen e kontratës së punës me të burgosurit e punësuar për nevoja shërbimi në IEVP dhe pagesat e tyre”*. Të burgosurve u krijohet mundësia për punësimin në kuadër të garantimit të fitimit, ruajtjes dhe zhvillimit të aftësive për punë dhe njohurive profesionale, për riintegrimin në shoqëri pas përfundimit të kryerjes së dënimit.

Masat mbrojtëse

Një objektiv i inspektimit, ishte verifikimi i funksionimit të sistemit të kërkesë/ankesave të të burgosurve për trajtimin e korrespondencave të tyre brenda institucionit dhe me institucionet e tjera qendrore.

Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, intervistat e zhvilluara me të burgosurit, si dhe nga kontrolli i regjistrave, rezultoi se, sistemi i kërkesë/ankesave funksiononte sipas kërkesave të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve dhe urdhrimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve³.

Në urdhër përcaktohej se, specialistët e sektorit të çështjeve shoqërore ishin personat përgjegjës të autorizuar të cilët në mënyrë periodike merrnin kërkesë/ankesat e të dënuarve/paraburgosurve. Në vijim, ata kryenin regjistrimin e tyre në regjistrin përkatës që mbahej në sektorin e protokoll-arshivës së institucionit dhe i dërgonin ato te drejtori i institucionit. Specialistët sipas sektorëve, në varësi të shënimeve të drejtuesit të institucionit, kryenin trajtimin dhe kthimin e përgjigjes brenda afatit të përcaktuar në rregulloren e institucionit⁴.

Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, për vitin 2022 ishin regjistruar rreth 553 kërkesa nga të burgosurit. Konkretisht 200 kërkesa për sektorin ligjor, për dinamikën dhe vërtetime që ndodhen në burg; 283 kërkesa për sektorin e policisë, për shoqërimin në bankë dhe për ndërrim dhome; 23 kërkesa për takim me drejtorin; 2 kërkesa për takim me mjekun dhe 45 kërkesa për punësim.

³ Neni 58, pika 5 e ligjit Nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.

⁴Neni 58 i ligjit Nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.

Grupi i inspektimit nuk mori ankesa në lidhje me procedurat që ndiqen nga stafi i institucionit në lidhje me trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesave të tyre nga drejtuesit e institucionit. Ata ngrinin problemin e vonesave në përgjigje të kërkesave të tyre nga DPB, kryesisht për ato kërkesa që kishin të bënin me transferimin në IEVP-të e tjera.

Gjatë inspektimit, grupi i punës verifikoi gjithashtu procedurat e ndjekura për hyrjet e reja të të burgosurve në institucion, ngritjen dhe funksionimin e komisionit të pritjes, intervistimin e të burgosurve, evidentimin e gjendjes shëndetësore dhe psiko-sociale të tyre, si dhe mënyrën e plotësimit të regjistrit dhe dosjeve personale të të burgosurve. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni u konstatua se, procedura e pranimit të të burgosurve që hyjnë rishtaz në institucion zbatohet në mënyrë korrekte nga komisioni i pritjes, praktikë kjo e cila ishte e evidentuar në libër dhe në regjistrin përkatës. Më tej, dokumentacioni protokollohej në sekretarinë e institucionit.

Aparatet e telefonave me kartë, ishin të instaluar në korridoret e secilit prej seksioneve në regjimin e brendshëm. Ata ishin në gjendje pune dhe nga intervistat me të dënuarit, ata deklaruan se flisnin me familjarët e tyre rregullisht 2 herë në javë, por, të dënuarit kërkonin që të shtoheshin aparatet e telefonit në seksione, pasi nga dy kompani telefonike që operonin në sistemin e burgjeve, aktualisht ishte vetëm një kompani, gjë e cila ka sjellë si pasojë që të ulen minutat e bisedës.

Në lidhje me telefonatat, të burgosurit paraqitën ankesa në lidhje me shtimin e operatorëve të tjerë me telekartë, pasi monopoli i këtij shërbimi në sistemin e burgjeve, ka sjellë për pasojë rritjen e çmimit të kartave telefonike dhe uljen e minutave të bisedave telefonike. Ky shqetësim është ngritur nga të burgosurit edhe në IEVP-të e tjera.

Grupi i inspektimit konstatoi gjithashtu se, numri i kontaktit me telefon me Avokatin e Popullit, nuk funksiononte pa tarifë shtesë për të dënuarit dhe ishte jashtë listës prej 10 numrash, të miratuar për të komunikuar të burgosurit, sikurse përcaktohet në ligjin nr.81/2020. Ky shqetësim është ngritur nga të gjithë të dënuarit në regjim, pasi numrat e telefonit të institucionit nuk ishin të lidhur drejtëpërdrejt pa kartë dhe pa pagesë nga kompania që ofronte këtë shërbim.

Sjellim në vëmendje të DPB-së, se këto problematika janë konstatuar nga grupet e MKPT-së edhe në IEVP-të e tjera, për të cilat është rekomanduar shtimi i operatorëve telefonik në sistemin e burgjeve, si dhe heqja e kufizimeve për të komunikuar me numrat e kontaktit të Avokatit të Popullit, por sikurse konstatohet edhe nga inspektimi në këtë IEVP, këto rekomandime ende nuk kanë gjetur zbatim.

Për sa i përket sistemit të monitorimit me kamera në ambientet e IEVP në Kosovë-Lushnjë, ishin të instaluar 36 kamera, që mbulonin 45% të territorit në institucion, ku vëzhgimi i tyre ishte funksional. Në IEVP Kosovë-Lushnjë monitoroheshin ambientet e regjimit të brendshëm, si dhe pjesërisht mjediset e jashtme të institucionit përgjatë 24 orëve. Të dhënat nga regjistrimet e kamerave ruhen në server për një periudhë 30 ditore. Pjesa më e madhe e ambienteve ishte e pa mbuluar me monitorimin me kamera në masë 55% të ambienteve të IEVP-së Kosovë-Lushnjë, për mbajtjen në vëzhgim të të gjitha ambienteve të këtij institucioni. Një gjë e tillë mund të jetë indicie për cënimin e elementeve të sigurisë së institucionit, por edhe për garantimin e zbatimit të të drejtave të të burgosurve.

Theksojmë se mbikëqyrja me kamera e të gjitha mjediseve të IEVP-së, përveç mjediseve ku çenohet privatësia, është vlerësuar nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, si një masë mbrojtëse ndaj personave të privuar nga liria për tri arsye:

Së pari, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundraligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve.

Së dyti, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të burgjeve dhe paraburgimeve, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

Së treti, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që harton vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si dhe institucionet monitoruese të pavarura.

Kushtet materiale

Grupi i inspektimit verifikoi edhe kushtet materiale, të cilat janë të rëndësishme për respektimin e standardeve normale të jetesës. Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale të IEVP-së Kosovë-Lushnjë **është një institucion i vjetër i ndërtuar në vitin 1976, si godinë**. Infrastruktura e institucionit përbëhet nga dy godina tre katëshe, me 44 dhoma në total.

Godinat dhe ambientet e dhomave të banimit në regjimin e brendshëm, ishin në gjendje të amortizuar, **lagështira ishte evidente disa ambiente si në dhomat e banimit, dhomat e veçimit e të observimit dhe më e theksuar ishte në ambientin e tualeteve në këtë institucion**. Niveli i lagështirës ishte tej normave të lejuara dhe për pasojë një gjë e tillë, ndikon drejtëpërdrejt në jetën dhe shëndetin e të dënuarve, si edhe për vetë punonjësit e policisë së burgut.

Muret e brendshme të këtyre ambienteve, ishin të dëmtuar nga prania e lagështirës, si dhe ndihej era e rëndë e mykut. Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, shkaku i lagështirës ishte se tarracat e godinave të banimit kishin nevojë për izolim dhe për rikonstruksione të ambienteve të brendshme. Nga ana e institucionit, ishin dërguar kërkesat me nevojat për investime drejtuar DPB, por ende nuk ishin siguruar fonde nga buxheti i shtetit për hidroizolim dhe tarracave të godinave. Prezenca e lagështirës në këto ambiente, dëmton rëndë shëndetin e personave që qëndronin aty, qoftë dhe për një periudhë të shkurtër kohore.

Baza materiale për akomodimin e të burgosurve dhe për jetesë normale, ishte e plotësuar. Në çdo dhomë banimi ishte siguruar kompletimi me krevat, dyshek, batanije e jastëkë dhe nga inspektimi nuk rezultoi të kishte asnjë person që flinte me dyshekë në tokë. Nga intervistat me të burgosurit, u evidentua fakti se pavarësisht se baza materiale përgjithësisht ishte e plotësuar, kishte të burgosur që deklarorin se batanijet dhe çarçafët i siguronin nga familjarët e tyre.

Ambientet në regjimin e brendshëm ishin sipas standardeve përsa i përket llojshmërisë, si klasat e edukimit dhe për këshillimin psiko-social në çdo sektor, dhomat për takimet me

familjarët, dhomat e prindërimit në distancë, klasat ku zhvillohej mësimi dhe për kurset profesionale, biblioteka, etj.

E drejta e besimit respektohej, dhe në institucion kishte hapësira të veçanta për ushtrimin e fesë, e cila realizohej në ditët e caktuara. Aktivitete fetare ofroheshin nga komuniteti mysliman shqiptar dhe shoqata kristiane e të burgosurve shqiptar.

Ambientet në regjimin e brendshëm kishin energji elektrike të pandërprerë që furnizohej nga rrjeti elektrik, por kishte dhe burim energjie rezervë me gjeneratorë, për furnizimin me energji elektrike në rast ndërprerje.

Problematikë ishte edhe furnizimi me ujë i të dënuareve në institucion, duke qenë se ata furnizoheshin me ujë vetëm 3 herë në ditë në 6 orë, përkatësisht në oraret 07:00-10:00 të mëngjesit., 13.00:15:00 të drekës, dhe 19:00 deri 21:00 të mbrëmjes. Mungesa e ujit nuk u siguronte atyre garantimin e higjienës së përshtatshme personale. Në gjykimin e Avokatit të Popullit furnizimi me ujë në 24 orë, do të ndikojë shumë, për mbajtjen e higjienës personale, për larjen e trupit dhe ruajtjen e pastërtisë në ambientet e përbashkëta për të dënuarit. Ndërsa, uji i pijshëm sigurohej nga njësia tregtare që ndodhej në regjimin e brendshëm, kundrejt pagesës nga të dënuarit.

Ambienti i dusheve ishte i përbashkët për çdo seksion dhe kishte nevojë për lyrje dhe mbajtjen pastër nga ana higjiëno-sanitare. Dushet ishin funksionale, por mungonin kokat e dusheve.

Grupi monitorues inspektoi situatën e trajtimit, kushteve materiale dhe atyre higjienike të të burgosurve në ambientet e observim/veçimit. Ky ambient përbëhej nga 8 dhoma observimi dhe 1 dhomë veçimi. Në ditën e inspektimit, në ambientin e observimit u konstatua se, dhomat ishin pajisur me një krevat, dyshek, batanije, si dhe çarçaf, në 6 dhoma, ndërsa 2 dhoma ishin të pajisur vetëm me krevat, ku mungonin dysheku, batanija, çarçafët etj. Ambienti në tërësi **nuk** ishte i pastër nga ana higjiëno-sanitare dhe kishte nevojë për lyrje. Në dhomat e veçimit mungonin pajisjet e domosdoshme për të përmbushur nevojat kryesore të jetesës, si tavolina, stola, komodina. Problematikë në këto ambiente ishte gjithashtu dhe mungesa e dushit për larjen e trupit të personave, pasi në mungesë të tij, larja e trupit duhet të bëhej në ambientet e dusheve të përbashkëta sipas sektorëve.

Në IEVP Kosovë-Lushnjë, funksiononte normalisht lavanderia, ku tashmë të 3 lavatriçet dhe 1 tharëse rrobash ishin në punë dhe të dënuarit merrnin shërbim pa vështirësi.

Kuzhina ishte në katin e parë të hapësirës së ndërmjetme midis dy godinave. Ambienti brenda ishte në kushte jo të mira higjiëno-sanitare. Pajisjet në të ishin të amortizuara dhe kampionët ushqimorë mbaheshin në frigorifer të mbyllur me dry, por kishte nevojë për përmirësimin e kushteve higjienike. Kjo situatë është e përsëritur dhe Avokati i Popullit adreson se ruajtja e higjienës brenda standardeve nuk lidhet me fonde buxhetore por kryerjen e detyrës me përgjegjshmëri. Gjithashtu, dhe aspiratori ishte jashtë funksionit në kuzhinë. Në kuzhinë ndodhej e afishuar kuota ditore, menuja, si dhe librezat shëndetësore të personelit të kuzhinës. Gatimi i ushqimit kryhej sipas kategorive të përcaktuara në rregulloren e brendshme të burgjeve, më vete për të dënuarit, për të punësuarit, si dhe për të sëmurët diabetik. Personeli i kuzhinës përbëhej nga 4 kuzhinierë sipas strukturës organike dhe 2 ndihmës kuzhinierë, të punësuar nga radhët e të dënuarve, si dhe nuk kishte

karroca për shpërndarjen e ushqimit deri tek të dënuarit. Në intervistat me të dënuarit, nuk u paraqitën ankesa lidhur me cilësinë e gatimit, pasi ajo ishte sipas urdhrimit të përbashkët të Ministrisë të Drejtësisë dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale⁵, por kishin nevojë për sasi të shtuar të ushqimit.

Regjimi dhe aktivitetet

Orari i veprimeve në regjimin e brendshëm ishte i miratuar dhe i afishuar në ambientet e regjimit të brendshëm, te vendi i kolonës ku qëndronte personeli i shërbimit të sigurisë për secilin sektor, në ambientet e klasave të edukimit, si dhe në vende të dukshme në ambientet e ajrimit. Ai përmbante veprimet e aktivitetit ditor, si dhe aktivitetet kulturore dhe sportive që zhvillohen sipas programit me të dënuarit.

Nga ana dokumentare, sektori i çështjeve shoqërore kishte të hartuar programe mujore pune, programe për trajtimet individuale psiko-sociale, si dhe plane mujore të aktiviteteve. Në rastin e festave kombëtare dhe festave fetare, në bashkëpunim me sektorin e policisë, ishin organizuar aktivitete të veçanta. Për secilin të dënuar dhe të paraburgosur ishin të plotësuara dosjet psiko-sociale.

Grupi i inspeksionit, zhvilloi intervista me të burgosurit dhe mori informacion në lidhje me llojshmërinë e aktiviteteve. Të burgosurit deklarorin se të vetmet aktivitete që organizoheshin në institucion ishin lojrat e tavolinës, kalçeto dhe aktivitetet fetare, ndaj ata ngritën ankesa për mungesën e llojshmërisë së aktiviteteve kulturore dhe sportive, që paraqisnin interes për të burgosurit, si dhe për mungesën e kontakteve të përditshme të stafit psiko-social me të burgosurit, me qëllim dhënien e asistencës në lidhje me problematikat që ata i shqetësonin.

Në këtë aspekt, autoritetet e institucionit kanë detyrimin që të organizojnë aktivitete të veçanta me të burgosurit, sipas nevojave që ata kanë. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon që të burgosurve duhet t'u organizohen veprimtari për kalimin e kohës së lirë, ku të përfshihen sportet, lojrat, aktivitetet kulturore, hobet dhe aktivitete të tjera. Gjatë veprimtarive të burgosurit duhet të lejohen të shoqërohen me njëri-tjetrin dhe bashkërisht të organizojnë kohën e lirë⁶.

Grupi i inspeksionit u informua lidhur me respektimin e të drejtës të të dënuarve për të patur kontakte me familjarët. Ambienti i takimeve të të burgosurve me familjarët në IEVP Kosovë-Lushnjë, kishte 1 post për takime online nëpërmjet kompjuterit, 4 poste për takime fizike me familjarët, 1 dhomë prindërimi në distancë dhe 1 dhomë për takime speciale për të burgosurit familjarë. Nga intervistat, rezultoi se të burgosurit zhvillonin 3 takime fizike, 1 takim online, dhe 8 biseda telefonike në muaj me familjarët e tyre, sipas përcaktimeve në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve⁷. Biseda online zgjaste deri në 20 minuta, për shkak dhe të fluksit të kërkesave për takime online të të dënuarve me

⁵ Urdhër i përbashkët i Ministrisë të Drejtësisë nr.1126 prot., datë 22.02.2022 dhe Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.995/1 prot., datë 07.03.2022 "Për miratimin e normave të ushqimit ditor për të dënuarit".

⁶ Pika 27.6 dhe 27.7 e Rregullores Evropiane të Burgjeve.

⁷ Aktualisht takimet me familjarët në të gjitha burgjet e vendit zhvillohen 4 herë në muaj, nga këto 3 takime fizike dhe 1 takim online, në bazë të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM nr.209, datë 06.04.2022.

familjarët e tyre. Grafiku i takimeve me familjarët, firmosej çdo ditë nga drejtori i institucionit.

Grupi i inspektimit nuk mori ankesa për zhvillimin e takimeve, por ata propozonin që me kërkesë të arsyetuar nga të burgosurit, takimi fizik të zëvendësohej me takime online me familjarët, brenda numrit të përgjithshëm të takimeve mujore, duke mos i kufizuar vetëm me një takim online.

Dhomat e prindërimit në distancë, ishin të pajisura me orenditë e nevojshme, si tavolinë dhe karrige, nga ku të paraburgosurit mund të takonin fizikisht fëmijët e tyre. Gjatë takimeve të të dënuarve me fëmijët dhe familjarët e tyre, në këto ambiente respektoheshin masat e sigurisë, si dhe privatësia e takimit.

Institucioni kishte bibliotekë për të dënuarit. Ajo ishte funksionale, por kishte një numër të kufizuar me libra dhe nuk i përmbushin të gjitha kërkesat për lexim të të dënuarve. Gjithashtu, kërkesat për leximin e librave ishin të reduktuara vitet e fundit. Të dënuarit që kërkonin t'u ofrohej ky shërbim, pasi regjistroheshin nga punonjësi i bibliotekës, ju hapej një kartelë personale dhe nëpërmjet saj tërhiqnin dhe dorëzonin librat sipas kërkesave.

Në IEVP ishin 3 fusha futbolli, të cilat ndikojnë shumë në gjendjen shpirtërore dhe fizike të të burgosurve, por në 2 fusha mungojnë të gjitha elementet, si rrjeta, portat, etj, për të qenë sa më kreativ për këtë qëllim.

Në institucion kishte një palestër por ajo nuk ishte pajisur plotësisht, ku sipas planit të aktivitetit ditor të dënuarit zhvillonin palestër një orë në ditë për çdo kat sipas sektorëve përkatës. Në lidhje me këtë të paraburgosurit ngritën si shqetësim mungesën e materialeve në palestër si psh. gira, shtanga të ndryshme sipas peshave, shtrimin me tapet, etj.

Mekanizmi Kombëtar thekson nevojën e menjëhershme të ndërthurjes së aktiviteteve kulturore-sportive dhe edukative me të burgosurit sipas grup moshave dhe kategorive, si dhe hartimin e programeve për këshillimin dhe trajtimin individual të këtyre personave, me qëllim që ata të kenë mundësi të ndërveprojnë me njëri-tjetrin, si dhe të mbushin sado pak atë boshllëk psikologjik dhe edukativ, që krijohet tek këta persona nga mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive me botën jashtë, gjatë periudhës të vuajtjes së dënimit.

Është për t'u theksuar se një ndër qëllimet e institucioneve të mbyllura penitenciare është riintegrimi në shoqëri i personave, në momentin që do të lënë burgun. Rregullorja Evropiane e Burgjeve parashikon se *“regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish. Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të kalojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre, sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror⁸”*.

Avokati i Popullit vlerëson se pavarësisht hapave të bëra në këtë drejtim Drejtorja e përgjithshme e Burgjeve duhet ë marrë masa që përtej dokumenteve strategjike komponenti i integritetit të ketë një përmirësim thelbësor në vitet në vijim.

Shërbimi Shëndetësor

⁸Rregullorja e Evropiane e Burgjeve Pika 25.1 dhe 25.2; <http://www.coe.int/t/DGHL/STANDARDSETTING/PRISONS/EPR/EPR-Albanian.pdf>

Grupi i inspektimit, gjatë vizitës inspektuese në I EVP Kosovë-Lushnjë i kushtoi një rëndësi të veçantë funksionimit dhe cilësisë së ofrimit të shërbimit shëndetësor të të dënuarve, për garantimin dhe ruajtjen e shëndetit të këtyre personave që vuajnë dënimin ose janë në pritje të dënimit në regjimin e burgjeve, si dhe krahasuar me standardet e përcaktuara në aktet ndërkombëtare për këtë qëllim.

Organika e sektorit shëndetësor përbëhet nga 7 (shtatë) punonjës prej të cilëve 1 (një) mjek me kohë part-time, 1 (një) stomatolog, 1 (një) farmacist dhe 4 (katër) infermierë. Staf i shëndetësor ishte i plotësuar sipas organikës dhe të punësuar me kohë të plotë, përveç mjekut i cili ishte i punësuar part-time.

Kjo nevojë bëhet edhe më emergjente në rastet e krizave shëndetësore si kjo aktualja, ku të dënuarit duhet ti nënshtrihen karantinës së detyrueshme, pas kthimit nga konsultat mjekësore pranë mjekëve në spitalet rajonale.

Në intervistat e zhvilluara me të dënuarit, u paraqitën ankesa se gjatë periudhës së pandemisë dhe kohës së zhvillimit të inspektimit, ka patur vonesa në kryerjen e vizitave mjekësore të mjekëve specialistë të spitaleve, sa për shkak të kufizimit të lëvizjeve dhe kontaktit me botën e jashtme, po aq dhe për mungesë të rekomandimit nga mjeku i institucionit.

Në vlerësimin e MKPT-së, kjo përbën mohim të së drejtës për të marrë shërbim mjekësor të specializuar në spitale të të burgosurve, të sëmurëve kronikë apo atyre që paraqesin shqetësime shëndetësore. Gjithashtu, kjo përbën edhe shkelje të standardit të përcaktuar në Rregulloren Evropiane të Burgjeve ku thuhet shprehimisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*⁹.

Në kushtet e mungesës së mjekut, personeli i infermierëve që jepen terapi në të sëmurëve kronikë dhe atyre akutë, ndiqnin procedurën sipas protokollit shëndetësor dhe njëkohësisht të masave të sigurisë në burgje, duke qenë vetë prezent në momentin e marrjes së terapisë dhe mos lënien e medikamenteve në dhomat e tyre.

Shërbimi shëndetësor ndodhet në një godinë jashtë regjimit të brendshëm, në një ambient të veçantë ku ndodhet dhoma e vizitave të mjekut, dhoma e stomatologut, farmacia dhe dhoma për konsultat ditore dhe rastet e urgjencës. Dhomat e vizitave ishin të plotësuara me krevat dhe shtroje, por kishin nevojë për tu mbajtur pastër nga higjieno-sanitare. Dhoma e stomatologut ishte e rregullt, e pajisur me autoklavë dhe poltron të ri dhe funksiononte rregullisht për ofrimin e shërbimeve të nevojshme.

Dhomat e mjekut, farmacistit, apo infermierisë ishin tejet të amortizuara, si të gjithë ambientet e këtij institucioni, dhe kishin nevojë për investime.

Lista e të sëmurëve kronikë përbëhet nga 30 persona, nga të cilët duke përfshirë dhe 2 persona diabetik dhe të sëmurë të shëndetit mendor. Të gjithë të sëmurët trajtoheshin me medikamente, ushqim dhe vizita mjekësore sipas rekomandimeve të mjekëve specialist.

⁹ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

Në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) Kosovë-Lushnjë, nuk kishte Sektor të Kujdesit të Veçantë, në një kohë që për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor duhet të tregohet kujdes i veçantë sa i takon përzgjedhjes së standardeve të dhomave ku do të qëndrojnë, ndaj higjienës vetjake të tyre, si dhe mjedisit që i rrethon.

Personat të cilët vuajnë nga çrregullime të shëndetit mendor, për shkak të sëmundjes së tyre, kanë nevojë për një vëmendje të veçantë, veçanërisht nga ekipi multidisiplinar i institucionit, siç parashikohet në pikën 4 të nenit 3 të ligjit 44/2012 “Për Shëndetin mendor”, ku thuhet se: "Ekipte multidisiplinare" janë ekipet e përbëra nga specialistë të disa fushave, si mjekë, infermierë, psikologë, punonjës socialë, terapistë okupacionalë, logopedistë, terapistë zhvillimi apo specialistë të tjerë, të cilët veprojnë në mënyrë të koordinuar, sipas protokolleve përkatëse për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit mendor¹⁰.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të stafit mjekësor e në veçanti atij të mjekut, u konstatua se, nga ana e tij ishin siguruar konsultime të vazhdueshme me të paraburgosurit. Sa i përket regjistrave, dhe konkretisht atyre të vizitave mjekësore, mjekimeve, konsultave të specializuara në Spitalin Rajonal të Qytetit ose në Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë, të personave me çrregullime të shëndetit mendor dhe abuzuesve me substanca narkotike/alkoolit, personave që refuzojnë terapinë, si dhe regjistri i informacionit 24 orësh të infermierëve, u gjetën të gjithë të sekretuar dhe të mbajtur në rregull. Kartelat mjekësore ishin të mbajtura në rregull dhe të mbyllura në dollap me çelës.

Një problem shqetësues në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kosovë-Lushnjë ishte dhe mungesa e një autoambulance, për transportimin në rast emergjence të të sëmurëve për në Spitalin Rajonal Lushnjë. Në këto kushte, nga drejtuesi i institucionit u informuam se, në rastet e emergjencave transporti i të sëmurëve për në Spitalin Rajonal, kryhej me autoambulancat e shërbimit të urgjencës Lushnjë, duke marrë masa shtesë për sigurinë fizike të të paraburgosurve. Ambienti ku kryheshin vizitat mjekësore ishte një mjedis i vogël dhe nuk kishte orenditë e nevojshme për kryerjen e këtij shërbimi. Gjithashtu, furnizimi me ilaçe i institucionit kryhej periodikisht nga sektori i shëndetësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, si dhe nëpërmjet blerjeve me fondet e akorduara në buxhetin e institucionit.

Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson kushtet infrastrukturore të krijuara për ofrimin e shërbimit shëndetësor të të burgosurve, por thekson se, mungesa e mjekut me kohë të plotë dhe mosfunksionimi i këtij shërbimi për t’iu përgjigjur në kohë kërkesave dhe nevoja të të sëmurëve në këtë institucion, shkakton në mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljen e së drejtës për qasje deri te mjeku nga ana e personave të dënuar.

Lidhur me këtë konstatim, KPT (CPT) në rolin e monitoruesit ndërkombëtar të respektimit të drejtave të të burgosurve, ka rekomanduar se: “*Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre*” dhe se, “*shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme*”.

¹⁰Pika 4 të nenit 3, të Ligjit nr. 44/2012 “Për shëndetin mendor”

Në këtë kuadër, vlen të theksohen edhe përcaktimi në Rregulloren Evropiane të Burgjeve, ku thuhet shprehimisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*¹¹.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”*.

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për gjetjen e fondeve përkatëse për ndërtimin/rikonstruksionin e godinave të banimit të të dënuarve në IEVP Kosovë-Lushnjë, për të siguruar ambiente të përshtatshme dhe dinjitoze.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për hidroizolimimin e tarracës të godinës së banimit, për eliminimin e lagështirës në dhomat e të dënuarve dhe në ambientet e përbashkëta të dusheve dhe tualeteve.
3. Marrjen e masave urgjente, për të krijuar ambientet e përshtatura për të ofruar shërbimet shëndetësore.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për përmirësimin e kushteve të higjienës në kushinë, në dhoma banimi dhe në ambientet e përbashkëta në institucion.
5. Marrjen e masave disiplinore për personat përgjegjës për ruajtjen e kushteve higjienike brenda standartit.
6. Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë ose 2 mjekë me kohë të pjesshme, me qëllim ofrimin e shërbimit shëndetësor për të burgosurit, mbi bazën e standardeve të parashikuara në legjislacionin në fuqi dhe protokolleve shëndetësore, sipas kategorive të të sëmurëve.
7. Marrjen e masave për organizimin e vizitave periodike me mjek psikiatër për të dënuarit me probleme të shëndetit mendor.

¹¹ Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

8. Marrjen e masave të menjëhershme, për akomodimin e personave të moshës 18-21 vjeç në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualët e sigurisë për këtë kategori.
9. Marrjen e masave të menjëhershme, për furnizimin me ujë të pijshëm 24 orë në ditë në ambientet e IEVP Kosovë-Lushnjë dhe deri në realizimin e plotë të investimit të rritet numri i orareve të furnizimit me ujë në 10 orë në ditë, nga 6 orë që është aktualisht.
10. Marrjen e masave të menjëhershme, për të realizuar mbulimin me kamera në të gjithë ambientet e IEVP Kosovë-Lushnjë, pasi masa 45% që mbulohet aktualisht është e papërshtatshme.
11. Marrjen e masave të menjëhershme, për eliminimin e plotë të lagështirës në ambientet e kuzhinës, si dhe blerjen e pajisjes për aspirimin dhe ventilimin e ajrit, si dhe lyrjen dhe mbajtjen pastër të këtyre ambienteve në IEVP Kosovë-Lushnjë.
12. Marrjen e masave të menjëhershme, për zëvendësimin e enëve të vjetëruara të kuzhinës që shpërbejnë për shpërndarjen e ushqimit të të dënuarve, me enë të reja, si dhe pajisjen e kuzhinës me figuriferë për të mbajtur produktet sipas stinëve.
13. Marrjen e masave të menjëhershme, për shtimin e produkteve sipas stinës, si dhe ushtrimin e kontrolleve të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit për këtë problematikë.
14. Marrja e masave të nevojshme, për furnizimin me detergjentë dhe pajisje higjieno-sanitare shtesë dhe sipas normativave mujore të burgosurit, për mbajtjen e higjienës dhe pastërtisë personale, dhomave të banimit dhe ambienteve të përbashkëta. Ushtrimin e kontrolleve të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit, për verifikimin e furnizimit me detergjente sipas normativave mujore të burgosurit, si dhe të marrjes së firmave të cilat vërtetojnë marrjen në dorëzim të këtyre materialeve prej tyre.
15. Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin e organikës së sektorit të çështjeve shoqërore me 2 punonjës psikolog/punë sociale, riorganizimin dhe vënien në efikasitet të punës së këtij sektori, me qëllim shtimin e kontakteve periodike të stafit me të burgosurit, si dhe në hartimin e programeve për rehabilitimin, këshillimin, ri-integrimin e të burgosurve dhe në organizimin e aktiviteteve edukative e social-kulturore-sportive me të burgosurit.
16. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e palestrës me materiale, si grrila, shtanga sipas peshës dhe vegla të tjera që ndihmojnë të burgosurit të kalojnë kohë shlodhëse në këtë drejtim.
17. Marrjen e masave për përmirësimin e menjëhershëm i kushteve në dhomat observimit dhe veçimit dhe pajisjen me shtretër e mjetet e nevojshme.
18. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e Sektorit të Kujdesit të Veçantë (SKV) në IEVP Kosovë-Lushnjë.

19. Marrjen e masave, për instalimin në godinën e të dënuarve të sistemit qendror për ngrohje/ftohje, si dhe ndërprerjen e lidhjeve të kablllove të rezistencave elektrike që përdoren për ngrohje, pasi përbëjnë rrezik për jetën e të dënuarve.
20. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen e institucionit me autoambulancë, për transportin e të sëmurëve në rastet e emergjencave shëndetësore.
21. Të merren masa të menjëhershme, për shtimin e operatorëve telefonik dhe vënien në punë të aparateve të telefonave që ndodhen në regjimin e brendshëm, për plotësimin e nevojave të të burgosurve për kryerjen e bisedave telefonike me familjarët e tyre, si dhe hapjen e linjës pa shpërblim për numrat e kontaktit me Avokatin e Popullit dhe komunikimin e të burgosurve me institucionin në lidhje me adresimin e ankesave.
22. Marrjen e masave alternative për shtimin e takimeve online duke zëvendësuar ato fizike sipas kërkesave të burgosurveve.

Për qëndrimin dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj.

KOMISIONER

Ahmet PRENÇI